



01 Nr. 160/25 Dt. 04.03.2025



Republika e Kosovës  
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit  
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 paragrafi f dhe g, të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), të nenit 3 paragrafi 4 dhe nenit 14 paragrafi 1.4 të Rregullores Komunale, nr. 001-011-201 datë 03.01.2024 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, Transfereve dhe Grantev, të Marrëveshjes së Bashkëpunimit Shtojca 1 nënshkruar ndërmjet Komunës së Prizrenit dhe Caritas Kosova 01 nr. 141/25 datë 20.02.2025, dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, kryetari i Komunës, merr këtë:

### V E N D I M Për lejimin e mjeteve

1. Lejohen mjetet financiare për bashkëfinancim në realizimin e projektit: “YourJob2”, i cili bashkëfinancim është i bazuar në nenin 3.2 të Marrëveshjes së Bashkëpunimit Shtojca 1 nënshkruar ndërmjet Komunës së Prizrenit dhe Caritas Kosova 01 nr. 141/25 datë 20.02.2025, kështu që, për këtë qëllim Komuna e Prizrenit, në emër të bashkëfinancimit për këtë projekt, lejon mjetet financiare në shumë prej 3600,00 € (tremijë e gjashtëqind euro).
2. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Marrëveshja e Bashkëpunimit Shtojca 1 nënshkruar ndërmjet Komunës së Prizrenit dhe Caritas Kosova 01 nr. 141/25 datë 20.02.2025.
3. Shuma e lejuar, e përshkruar si në pikën 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës–pozicioni i subvencioneve dhe transfereve i Zyrës së Kryetarit të Komunës dhe mallra dhe shërbime të Komunës së Prizrenit.
4. Obligohet Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
  - Caritas Kosova,
  - Arkivës së Kryetarit.

Kryetari i Komunës  
Shaqir Totaj

